



VENDIM
Nr.102 Datë 07.12.2010

PËR
PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT UNIK TË SHITJES SË ENERGJISË
ELEKTRIKE PËR TË LICENSUARIT PËR PRODHIMIN E
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HIDROCENTRALET EKZISTUESE
ME FUQI TË INSTALUAR DERI NË 10 MW PËR PERIUDHËN 1
JANAR - 31 DHJETOR 2011

Në mbështetje të neneve 9, 26 pika 1, 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 15, 20 dhe 21 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s Nr.21, datë 18.03.2009, Vendimit nr.5, datë 26.01.2007, të Bordit të Komisionereve të ERE-s “Për miratimin e metodologjisë së percaktimit të cmimit të shitjes së energjisë elektrike për të licensuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet ekzistues me fuqi të instaluar deri në 10 MW”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 07.12.2010, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Cmimeve për percaktimin e cmimeve të shitjes së energjisë elektrike për të licensuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet ekzistues me fuqi të instaluar deri në 10 MW, për periudhën 1 Janar-31 Dhjetor 2011,

Vendosi :

1. Çmimi unik i shitjes së energjisë elektrike për të licensuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet ekzistues me fuqi të instaluar deri në 10 MW për periudhën 1 Janar – 31 Dhjetor 2011 do të jete 7.57 leke/kWh.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e të licensuarve dhe të KESH sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

